

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME *ACQUIS* TË
BASHKIMIT EVROPIAN – ARRITJET DHE SFIDAT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË INTEGRIME EVROPIANE DHE
ADMINISTRATË PUBLIKE

NGA

VENHARD MUSHLA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE
INTEGRIME EVROPIANE DHE ADMINISTRATË PUBLIKE
PRISHTINË

Shtator, 2022

Rezyme e temës master

Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me *acquis* të Bashkimit Evropian – arritjet dhe sfidat

Student: Venhard Mushla

Mentor: prof.ass.dr. Bardhok Bashota

Trendi për të harmonizuar legjislacionin e Kosovës me *acquis* të Bashkimit Evropian vërehet që është në rritje mirëpo, përkundër faktit që është krijuar programi kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit ka nevojë për më tepër përpjekje nga të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces, sepse sa më afër harmonizimit të legjislacionit aq më afër është edhe rruga drejt integritimit në Bashkim Evropian.

Përafrimi i politikave të Kosovës me ato të Bashkimit Evropian ka filluar me mekanizmin përcjellës të stabilizimit, i cili ishte pjesë e politikës së procesit të stabilizim-asociimit të Bashkimit Evropian ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vazhdon me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.

Me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të marrëveshjes së stabilizim-asociimit në vitin 2016, Kosova hyri në marrëdhënie të vetme dhe të parë kontraktuale me Bashkimin Evropian. Me këtë marrëveshje është zotuar që të përafrojë legjislacionin vendor me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe të sigurojë zbatueshmërinë e legjislacionit të përafuar.

Punimi analizon të arriturat dhe sfidat të cilat i ka Kosova në drejtim të harmonizimit të legjislacionit vendor me *acquis* të Bashkimit Evropian, në veçanti faktorët të cilët kanë ndikuar në ngadalësimin e këtij procesi.

Dy pyetjet hulumtuese që janë ngritur në këtë hulumtim janë:

1. Ku ka ngecje dhe cilat janë sfidat në përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis* të Bashkimit Evropian?
2. Sa është e mundur të përshpejtohet trendi i harmonizimit të legjislacionit vendor me *acquis* të Bashkimit Evropian?

Përveç pyetjeve hulumtuese, në përbërjen e këtij punimi janë ngritur edhe dy hipoteza:

1: Kosova ka bërë përpjekje të vazhdueshme dhe ka arritur dukshëm të harmonizojë legjislacionin vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis*).

2: Kosova ende mbetet larg për të arritur harmonizimin e plotë të legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian në fushën e kapitujve 22 dhe 23.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të analizohen arritjet dhe sfidat që i ka Kosova në drejtim të përafrimit të legjislacionit vendor me legjislacionin e Bashkimit Evropian – *acquis*, reformat e bëra si dhe mënyrat për të përshpejtuar harmonizimin e legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së, e në veçanti në kapitujt më të rëndësishëm, për të plotësuar kushtet për anëtarësim.

Punimi përbëhet prej gjashtë kapitujve:

Kapitulli i parë: përshkruan cilësitë e BE-së, kushtet dhe procedurat që një shtet duhet të përmbush për të aderuar në Bashkimin Evropian, bazën juridike për pranimin e shteteve të reja, cilat janë kushtet dhe procedurat për anëtarësim duke përfshirë përshkrimin e Kritereve të Kopenhagës 1993 dhe Madridit të vitit 1995, dhe përfundon me kushtet dhe kohën e miratimit dhe zbatimit nga kandidati i të gjitha rregullave aktuale të BE-së “*acquis*”.

Kapitulli i dytë: ofron një përmbledhje të rendit juridik dhe trashëgiminë juridike të Bashkimit Evropian. Ky kapitull fillon me burimet e së drejtës së BE-së, legjislacionin primar dhe sekondar, vazhdon me epërsinë e së drejtës së Bashkimit Evropian duke marr disa shembuj të doktrinës së efektit direkt dhe përfundon me përbrendësimin e së drejtës së Bashkimit Evropian.

Kapitulli i tretë: analizon marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor në kuadër të procesit të stabilizim asociimit, këtu paraqitet një përmbledhje e rrugëtimit dhe hapja e perspektivës Evropiane për Ballkanin, çfarë ka qenë mbështetja e BE-së në ndërtimin e kapaciteteve për vendet e Ballkanit lidhur me adoptimin dhe implementimin e të drejtës së saj vazhdon më tutje me pozicionin e Kosovës në kuadër të dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit dhe sfidat e saja prej Mekanizmi Përcjellës tek Dialogu për PSA, dhe në fund, sa ka arritur Kosova të harmonizojë legjislacionin e saj me *acquis* deri para pavarësisë.

Kapitulli i Katërt: paraqet, marrëdhëniet kontraktuale BE-Kosovë konkretisht, marrëveshjen e stabilizim asociimit, e cila është një marrëveshje e parë kontraktuale dhe e cila u bë e mundur përmes Traktatit të Lisbonës. Vazhdon me kornizën ligjore të bashkëpunimit, dhe përfundon me Agjendën për Reforma Evropiane e cila paraqet një proces të dialogut të nivelit të lartë në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian i cili është një dokument që përmban prioritetet kryesore të obligimeve që dalin nga MSA-ja

Kapitulli i pestë: – Në këtë kapitull analizohet harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me *acquis* të BE-së, shqyrtohet roli i Mekanizmit për Shqyrtim Legjislativ si pjesë e detyrave të Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (PSBE) në Kosovë, që të bëjë bashkërendimin dhe konsolidimin e legjislacionit të Kosovës përmes ekspertizës së BE-së, vazhdon me arritjet dhe në fund me sfidat e Kosovës në harmonizim të legjislacionit me kapitujt më të rëndësishëm të *acquis* të Bashkimit Evropian.

Kapitulli i gjashtë: tek përfundimet, janë shqyrtuar, vlerësimet e Komisionit Evropian në gatishmërinë e Kosovës për të adoptuar detyrimet për anëtarësim në BE, sa ka ndikuar stabiliteti politik, zgjedhjet e parakohshme, shumica e pamjaftueshme parlamentare dhe efekti i pandemisë në trendin e përafrimit të legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së, pastaj analizimi i propozimit të Komisionit për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës që është ende në pritje në Këshill, dhe një analizë krahasuese me Kosovës dhe Kroacisë së përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE.